



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 25.05.2023

Nr: 146

Ora: 16:10

VENDIM

**PËR KTHIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 84, TË DEPOZITUAR NË KQZ NË DATËN 24.05.2023
NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 25.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor "Aleanca Demokristiane e Shqipërisë"

OBJEKT:

1. Kundërshtim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kamëz dhe hartimin e tabelës së re përmbledhëse pas kqyrjes së materialit zgjedhor sipas kësaj kërkesë ankimore.
2. Rivlerësim i votave të vlefshme dhe të pavlefshme për disa subjekte në disa prej kutive të votimit për Këshillin Bashkiak Kamëz.



3. Rivlerësim për ndryshimet e pamotivuara në Tabelën Elektronike të Rezultateve përmbledhese për Këshillin Bashkiak Kamëz.

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 84 regj., datë 24.05.2023.

Në mbledhjen e datës 25.05.2023, ora 16:10, pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta. Konkretisht:

Së pari: Në ankim nuk është referuar vendimi që ankimohet, sipas parashikimit të nenit 126, pika 1, shkronja “b” të Kodit Zgjedhor, në përputhje me të cilën duhet saktësuar objekti i kërkesës ankimore.

Së dyti: Ankimi zgjedhor nuk përmban elementin e bazës ligjore ku mbështetet kërkesa ankimore. Subjekt ankimes duhet të saktësojë bazën ligjore ku mbështeten pretendimet e tij, sipas parashikimit të nenit 126, pika 1 shkronja “c” të Kodit Zgjedhor.

Së treti: Ankuesi nuk ka depozituar së bashku me ankimin, një përshkrim më të detajuar dhe të saktë të fakteve, argumenteve dhe dispozitave ligjore, ku mbështetet ankimi sipas parashikimit të nenit 126, pika 1 shkronja “d” të Kodit Zgjedhor.

Së katërti: Ankimi i paraqitur në KAS nuk është shoqëruar me asnjë provë dhe nuk tregon asnjë provë që kërkohet të merret gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, në funksion të zgjidhjes së çështjes, sic parashikohet në nenin 126, pika 1, shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor. Pas saktësimit të objektit të kërkesës ankimore, pala ankimese duhet të riorganizojë provat në përputhje me këtë objekt.

Në bazë të nenit 129, pika 1, të Kodit Zgjedhor, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij Kodi. Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i kësaj procedure të plotësimit të formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e shkronjave “b”, “c”, “d” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 126, si dhe të shkronjës “b”, të pikës 1 të nenit 130 të Kodit Zgjedhor, ajo duhet t’i kthehet për plotësimin e elementeve të formës, sipas përcaktimeve të cituara si më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 84, datë 24.05.2023 për plotësim të elementëve të formës.
2. Seanca paraprake do të zhvillohet më datë 26.05.2023, ora 16:00.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palës në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit paraprak, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

U shpall sot më datë 25.05.2023.

Ilirjan	RUSMALI	- Relator
Elvin	LAKO	- Anëtar
Elvis	ÇEFA	- Anëtar
Koli	BELE	- Anëtar
Ledio	BRAHO	- Anëtar